



Institucioni i Arsimit
UNIVERSITAR AAB

Fakulteti: SHKENCA SOCIALE

Programi : Përkujdesja dhe Mirëqenia e Fëmijëve

Lënda: **EDUKIM PARASHKOLLOR**

Msc. Tylaj Hasanaj

2015 Ferizaj

1. PEDAGOGJIA PARASHKOLLORE SI DISIPLINE SHKENCORE PEDAGOGJIKE

1.1. Lënda dhe detyrat e pedagogjisë parashkollore

- Pedagogjia është shkenca e cila merret me studimin e fenomeneve edukative.
- Pedagogjia parashkollore është disiplinë pedagogjike, e cila merret me studimin e specificiteteve të procesit të edukimit të fëmijës në moshën parashkollore.

Detyrat e pedagogjisë parashkollore:

1. Të zbuloj të vërtetat shkencore në fushën e edukimit dhe arsimimit parashkollor, si dhe faktorëve që direct ose indirect ndikojnë në zhvillimin e fëmijës parashkollor.
2. Insiston që qëllimisht dhe me plan, të ndryshojë praktikën edukative-arsimore parashkollore, duke u mbështetur në dituritë e veta teorike e shkencore mbi edukatën parashkollore.
3. Krahas studimit të përvojave positive, e ka për detyrë të merret edhe me studimin e normave, vlerave dhe bindjeve në jetën praktike të rrethit të caktuar.
4. Të përkujdeset për bartjen dhe aplikimin e të arriturave të veta teorike në praktikën edukative parashkollore dhe që sistematikisht t'i përcjell rezultatet e aplikimit të tillë.
5. Të jetë gjithnjë kritike, si ndaj lëndës së vet të studimit, ashtu edhe ndaj vetvetes, përkatësisht ndaj bazave filozofike, teorike dhe shoqërore.
6. Të vëhet në raporte interdisiplinare me disiplinat tjera shkencore, e sidomos me disiplinat pedagogjike dhe psikologjike.

1.2. Konstituimi i pedagogjisë parashkollore si disiplinë shkencore pedagogjike

- Mendimet dhe idetë e para mbi edukatën parashkollore ishin tejet të hershme, qysh në Greqinë e vjetër e sidomos në veprat e Platonit dhe Aristotelit.
- Gjatë periudhës së mesjetës që zgjati më shumë se 1200 vjet nuk pati ide rreth edukatës parashkollore.
- Qëndrimi I Islamit ndaj edukatës parashkollore.
- Paraqitja e ideve dhe mendimeve pedagogjike mbi edukatën parashkollore me paraqitjen e renesansës dhe të humanizmit.
- Pedagogët klasikë që u morrën me këtë disiplinë pedagogjike janë: Jan Amos Komenski, Xhon Loku, Zhan Zhak Rusoi, Joha Pestaloci, Sharl Furie, Robert Oveni, Fridrih Frebeli, Maria Montessori etj.
- Për konstituimin e pedagogjisë parashkollore, si disiplinë e veçantë shkencore pedagogjike, kontribut të madhë ka dhënë edhe mjekja Maria Montessori, e cila bëri përpjekje që sistemin e vet original të pedagogjisë parashkollore ta mbështesë në fakte shkencore.
- Zhvillimet më intensive në fushën e pedagogjisë parashkollore fillojnë që nga viti 1960.
- Studimet e ndryshme kanë vërtetuar se moshja parashkollore është moshja më e përshtatshme për zhvillimin e mëturjes të personalitetit të njeriut.
- Si rezultat i kërkimeve shkencore, në kuadër të shkencave pedagogjike lindi dhe u konstitua Pedagogjia parashkollore.

1.3. Pedagogjia parashkollore në sistemin e disiplinave shkencore pedagogjike

- Lidhshmëria mes pedagogjisë parashkollore dhe disiplinave tjera, si: pedagogjia familjare, historia e pedagogjisë, metodologjia e pedagogjisë, etj.
- Pedagogjia parashkollore merret me studimin e të gjithë faktorëve, që ndikojnë në zhvillimin e fëmijës si p.sh.familja, institucionet parashkollore, si dhe shumë faktorë të tjerë që kanë rëndësi për zhvillimin e fëmijës në shoqërinë, ku fëmija rritet dhe në ambientin e tij natyror, por edhe të faktorëve të tjerë që marrin pjesë në veprimet ndikuese edukative për zhvillimin e fëmijës.

2. METODOLOGJIA E PEDAGOGJISË PARASHKOLLORE

2.1. Zhvillimi i metodologjisë shkencore pedagogjike parashkollore

- Prej kohës antike e deri kah fundi shek.XIII, mendimet, idetë dhe qëndrimet mbi edukatën parashkollore paraqitnin spekulimet e njerëzve intelektualë, por jo edhe rezultatet e kërkimeve shkencore.
- Në fund të shek.XVIII, mjeku gjerman TIDEMAN, e bëri biografinë e parë-studimin detaj biografik të fëmijës.
- Në fund të shek.XIX, një nxitje të posaçme në kërkimtarinë shkencore mbi zhvillimin e fëmijës edhe psikologu amerikan S.Holli, themelues i “Lëvizjes mbi studimin e fëmijëve”.
- Zhan Piazhe, psikolog zviceran, kishte rëndësi të madhe në begatinë kërkimore shkencore pedagogjike parashkollore.
- Nën ndikimin e Frojdit, në periudhën 1935-1945 bëhen studimet mbi pasojat e ndarjes së fëmijës nga gjiri I nënës.
- Pas vitit 1960 e deri më sot janë arritur rezultate të jashtëzakonshme.

2.2.Kërkimtaria shkencore dhe implikimet filozofike rreth konstruktimit të programeve bashkëkohore të arsimit parashkollor

- Për laramaninë e programeve parashkollore, shkaktare ishin dy tendenca themelore:
 - a) **Tendenca funksionaliste ose biheavioristike:** Në këtë grup bëjnë pjesë të gjitha ato programe sipas të cilëve arsimimi I fëmijëve duhet të jetë mësimdhënie direkte ose trajnim I aftësive, prirjeve dhe I faktorëve të intelegjencës së fëmijëve, që janë fituar me anën e kërkimeve psikomotorike dhe të cilat duhet të fitohen me anën e metodave direkte e me motivizim të jashtëm.
 - b) **Tendenca humaniste:** Sipas këtyre programeve, arsimi duhet të jetë si arsim indirect dhe nxitje e pasur për tërë potencialin e tërësishëm mental të fëmijës.

2.3.Metodat në hulumtimin pedagogjik parashkollor

- Kërkimet dhe hulumtimet shkencore në lëmin e pedagogjisë parashkollore, para se gjithash kërkojnë shfrytëzimin e drejtë të metodave, veprimeve dhe teknikave shkencore.
- Vetë natyra e problemeve të pedagogjisë parashkollore detyron që gjatë kërkimeve shkencore të shfrytëzohen këto metoda: a) metoda historike; b) metoda analitiko-deskriptive dhe c) metoda eksperimentale.

A) Metoda historike:

- Metoda historike ka rëndësi të veçantë për studimin e institucioneve parashkollore në etapat e ndryshme historike.
- Burimet, me të cilat mund të shërbehet kërkuesi shkencor, I cili përdor këtë metodë janë:
 - Historia e pedagogjisë
 - Veprat pedagogjike të pedagogëve klasik
 - Monografitë

- Studimet të cilat i përpunojnë problemet individuale pedagogjike dhe sociologjike.
- Për aplikimin e kësaj metode, karakteristike janë tri etapa:
 - a) grumbullimi I shënimeve dhe fakteve
 - b) të vështruarit kritik
 - c) interpretimi pedagogjik I tyre.
- B) Metoda analitiko-deskriptive:**
- Metoda analitiko-deskriptive ka rol të madh për të zbuluar problemet praktike në edukatën parashkollore.
- C) Metoda eksperimentale:**
- Me metodën eksperimentale dukuritë pedagogjike vëzhgohen, studiohen, se në ndonjë situatë futet ose përjashtohet një ose më shumë faktorë edhe atë qëllimisht për të kontrolluar rezultatin c ndikimit të atyre faktorëve.

2.4.Teknikat dhe instrumentet në hulumtimin pedagogjik parashkollor

- A) Të vërejturit** mundëson që të përcjellim dhe të regjistrojmë trajata dhe format individuale të sjelljes së fëmijës apo të ndonjë grupi fëmijësh, duke pasur gjithnjë parasysh qëllimin e caktuar.
- B) Intervista:** Kjo metodë përdoret në ato raste ku dëshirohet të studiohen: dëshirat, qëndrimet dhe të menduarit e fëmijëve.
- C) Kestioneri-** është kryesor për grumbullimin e fakteve, që zakonisht përdoret tek metoda analitiko-deskriptive. Kestioneri përdoret për grumbullimin e informacioneve prej edukatorëve, prej prindërve etj, por jo edhe fëmijëve drejtë për së drejti.

NOCIONET THEMELORE TË PEDAGOGJISË PARASHKOLLORE

1. Socializimi:

- Socializimi mund të definohet në dy mënyra:

1.1. Në kuptimin e ngushtë, socializimi definohet si fitim i shkathtësive, diturive, motiveve dhe qëndrimeve, të cilat individit i nevojiten për t'i kryer rolet shoqërore sot dhe për shoqërinë e ardhshme.

1.2. Në kuptimin e gjërë, socializimi ka të bëjë me definicionet psikologjike të cilat theksojnë se rezultati i socializimit të një individi në shoqëri gjegjëse s'është vetëm fitim i formave të përbashkëta të sjelljes, por njëherit edhe formimi i personalitetit të vet. Socializim, pra është përvetësim i formave të caktuara të sjelljes.

2. Personalizimi:

- Personalizimi ka të bëjë me atë pjesë të kulturës, e cila ndikon vetëm në zhvillimin e individit. Me anë të personalizimit realizohet personaliteti i individit. Derisa socializim do të thotë edukim për shoqërinë, personalizimi është edukim për vetveten.

3. Inkulturacioni:

- Inkulturacioni përfshinë, sikurse edhe edukata, ndikimet qëllimore ashtu edhe ato spontane për zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Me këtë term na paraqitet edhe nocioni i kulturës.

- Kultura i përfshinë të gjitha format e komunikimit, së pari të folurit, pastaj të gjitha monumentet e të së kaluarës, dokumentet e të sotmes dhe projeksionet e të ardhmes, të gjitha marrëdhënjet prodhuese dhe shoqërore e ndërnjerëzore, si dhe normat e rregullimit të atyre marrëdhënieve (juridike, morale(), shprehjet artistike, shkencat dhe superstrukturën shoqërore, religjionin etj.

Inkulturacioni është proces i pranimit të kulturës në kuptimin e saj më të gjërë.

4. Edukata:

- edukata është ajo veprimtari e vetëdijshme me anën e së cilës zhvillon vetitë fizike dhe psikike të njeriut. Atëherë, kur ta bëjë me ndikimet ndaj vetvetes, veprimtaria e tillë quhet vetë edukatë.

5. Arsimi:

- Arsimi është segment i procesit edukativ, me anë të cilit nxiten dhe orientohen të gjitha llojet e aktiviteteve njohëse, nepërmjet të të cilit fitohet, përsoset, formësohet dhe zgjerohet përvoja e fëmijëve, përkatësisht aktivitetet njohës që e nxisin dhe e orientojnë përcjelljen e njohurive të zgjedhura, të cilat njerëzit gjatë zhvillimit të tyre i grumbullojnë dhe i strukturojnë në fushat e ndryshme shkencore, teknike, të punës, të prodhimit, të artit dhe të raporteve shoqërore.

- fëmija kryesisht me anën e arsimit i plotëson nevojat e veta për interaktivitet.
- Arsimi që të mund t'i realizojë funksionet e veta edukative, duhet të mbështetet:
 - a) në interesimet njohëse të fëmijëve për jetën e vërtetë dhe për ambientin social dhe natyror i cili e rrethon;
 - b) në kërkshërinë për dituri të reja dhe nevojat e fëmijëve për kërkimtarë kreative;

- c) Në faktin se me anën e procesit arsimor duhet zhvilluar motivet njohëse, qëndrimin kritik, besimin e fëmijëve ndaj mundësive personale, prirjet e tyre për të gjurmuar sa më tepër.
- d) Gadishmërinë për të këmbyer përvojat me të tjerët.

6. Përvoja:

- Fitimi I përvojës, si formë aktive e të mësuarit nëpërmjet praktikës jetësore, duhet nënkuptuar si pjesmarrje dhe angazhim personal të fëmijës.
- Përvoja luan rol të madh për zhvillimin e aftësive dhe për fitimin e diturive dhe të shkathtësive.
- Llojet e përvojës parashkollore janë:
 - a) Përvoja shqisore (fitohet me anën e të gjitha shqisave)
 - b) Përvoja motorike (përshtypjet nga bota fizike të fituara me anën e lëvizjeve;
 - c) Përvoja simbolike (aktivitetet vepruese dhe manipuluese të fëmijës).

7. Dituria:

- Dituria paraqet vetëdijen objektive mbi diçka.
- Dituria është rezultat i të mësuarit dhe i përvojës personale të përpunuar dhe të sistematizuar, por edhe rezultat i fitimit të përvojës kolektive, të cilën njerëzit e kanë mbledhur, akumuluar dhe e kanë rregulluar në sisteme të njohurive shkencore, morale, estetike etj.

8. Të mësuarit:

- Të mësuarit është process I fitimit të përvojës dhe të përvetësimit të diturive, I cili drejtohet me arsim, duke qenë I varur edhe nga vetë angazhimi (aktiviteti) I individit.
- Me anë të mësuarit zbulohet dhe përvetësohet bota.
- Të mësuarit mbështetet në kërkuesin, në etjen për dituri dhe kureshtje-si dëshira që gjithçka të kuptohet, të sprovohet, të njihet dhe të mësohet nga ana e fëmijës.
- Të mësuarit është **kusht** dhe **mënyrë** e fitimit dhe e zhvillimit të diturive, shkathtësive, shprehive dhe aftësive të nevojshme, për jetën e fëmijëve dhe për futjen e tyre në shoqëri, si dhe në arsimin formal (shkollë fillore), por edhe vetë në vetësimim.

9. Interiorizimi:

- Kuptimi dhe qëllimi I tërë procesit edukativ është zhvillimi I fëmijës, zhvillimi ky I cili arrihet me përvetësimin e përmbajtjeve edukative (dituritë, aftësitë, qëndrimet, shkathtësitë motorike etj), dmth zhvillimi I cili arrihet me anën e INTERIORIZIMIT.
- Interiorizimi (lat.-I brendshëm) zakonisht realizohet bashkë me vetë edukimin.

10. Personaliteti:

- Personaliteti I njeriut lind në saje të ndikimeve, të cilat e mundësojnë zhvillimin dhe orientimin e përgjithshëm, si dhe aftësimin e njeriut për jetë dhe punë.

-Me formimin e përgjithshëm të personalitetit nënkuptojmë komponenten fiziologjike dhe psiqike të njeriut, në saje të së cilës zhvillohet intelektin, ndjenja, vullneti, aftësitë punuese dhe creative, si dhe vetitë moralo-shoqërore, kombëtare e fetare të fëmijës.

-Ndikimet edukative, posaçërisht janë të rëndësishme në moshën e hershme fëmijërore.

-Njeriu mëson dhe edukohet prej lindjes e deri në pleqëri.

-Fëmija, në moshë parashkollore identifikohet plotësisht me personat e rritur dhe lidhet ngushtë me sjelljet dhe qëndrimet e tyre.

11. Edukatorja:

-Pedagogjia parashkollore e thekson rolin vendimtar të edukatores së realizimit të qëllimeve dhe të detyrave shoqërore-kombëtare dhe pedagogjike, ngase aktiviteti dhe puna edukativo-arsimore në institucione parashkollore realizohet nën udhëheqjen dhe drejtimin e edukatores.

-Roli i edukatores është tejet delikat dhe i ndërlikuar, nga se gabimet e bëra gjatë punës së edukatorës kanë pasoja të rënda dhe shpesh herë ato mund të bëhen pengesa për zhvillimin dhe përparimin e fëmijës gjatë tërë jetës së tij.

-Edukatorja e organizon dhe e drejton procesin edukativ.

-Edukatorja fëmijët i fut në mënyrë të organizuar në botën e natyrës dhe të shoqërisë, me qëllim që tek fëmijët t'i zhvillojë shqisat, aftësitë intelektuale, estetike dhe vetitë morale-kombëtare-fetare.

-Edukatorja duke bashkëpunuar me familje, me prindërit e fëmijëve, ajo kontribon në ngritjen dhe zhvillimin e vetëdijes mbi rëndësinë e edukimit të drejtë familjar.

-Edukatorja e ka rolin e bashkëpuntores familjare, pastaj rolin e një konsultante dhe të këshilltares familjare.

-Lidhja gjithnjë më e fortë e edukimit parashkollor me shkollën fillore, ndikon që të rritet numri i detyrave edukativo-arsimore, të cilat duhet t'i realizojë edukatorja.

-Edukatorja përveç punës së vet me fëmijë në institucion parashkollor, duhet të merret edhe me punë të ndryshme shoqërore-kombëtare dhe kulturore.

Personaliteti i edukatores:

Suksesi i edukatores varet nga këto faktorë:

- a) Arsimi i përgjithshëm-kulturë e gjerë e përgjithshme dhe shkallë e lartë e intelegjencës;
- b) Njohuria e meritueshme e procesit edukativ dhe e psikologjisë së fëmijëve parashkollore.
- c) Aftësia vëzhguese;
- d) Takti pedagogjik: Me këtë nënkuptohet, cilësitë pedagogjike të personalitetit të edukatores, siç janë: qëndrueshmëria, përballimi, ekuilibriteti mental etj;
- e) Stabiliteti emocional i edukatores;
- f) Arsimi (shkollimi) i edukatores për punë pedagogjike parashkollore.

EVOLUMI I IDEVE PEDAGOGJIKE MBI EDUKATËN PARASHKOLLORE

1. Edukata parashkollore në Spartë

- Sparta ishte shtet me rregullimin ushtarak;
- Në Spartë, I tërë qëllimi kryesor I edukatës ishte formimi I njeriut patriot;
- Qëllimi kryesor I edukimit në familje të Spartës ishte zhvillimi trupor dhe fizik I fëmijës
- Fëmijët deri në moshën 7 vjeçare edukoheshin në familje;
- Nëse pleqësia vlerëonte pozitivisht se fëmija është I aftë për jetë, ai mbetej për të jetuar, në të kundërtën fëmija zhdukej.

2. Edukata parashkollore në Athinë

- Athina ishte shtet I fortë dhe I hapur ndaj shteteve tjera;
- Në Athinë gjithçka I ishte nënshtuar idealit, dhe ideal ishte para se gjithash kryerja e punëve personale;
- Qëllimi I edukatës ishte edukimi I njeriut të gjithëanshëm, personalitet I edukuar në pikëpamje fizike, intelektuale, estetike e morale;
- Në Athinë, fëmijët qëndronin një kohë më të gjatë në familje se sa ato të Spartës;
- Në Athinë, nënat e fëmijëve ishin më të arsimuara.

3. Platoni (428-342 p.e.r.)

- Sipas Platonit, edukata dhe edukimi I fëmijëve duhet të jetë obligim I shtetit;
- Platoni idetë e veta mbi dukatën I shtjelloi na librat e veta të njohura “Ligjet” dhe “Shteti”.
- Sipas Platonit, puna educative me fëmijët asesi nuk guxon të shtyhet, përkundrazi edukimi I fëmijës duhet të fillojë prej çasteve kur ka lindur fëmija;
- Platoni këshillon se si nënat nuk guxojnë të mërzhiten dhe të nervozohen;
- Për Platonin, nuk ishte e pranueshme, përkëdhelja e tepruar, e as tirania, tortura apo shtypja e fortë ndaj fëmijës, sepse kjo fëmijën do ta detyronte ta gjejë rrugën e mesme;
- Platoni u kushtoi vëmendje të konsiderueshme lojërave të fëmijës;
- Mjetet më të përshtatura për edukimin e fëmijës, Platoni I konsideronte letërsinë dhe muzikën;
- Sipas Platonit, edukimin e fëmijëve parashkollorë duhet ta udhëheqin dhe ushtrojnë vetëm edukatorët e shkolluara;
- Platoni I pati parasysh dallimet individuale mes fëmijëve gjatë edukimit.

4. Aristoteli(384-322 p.e.r.)

- Sipas Aristotelit, natyrën njerëzore e përbëjnë këto tri komponente:
 - a) Komponenta trupore-natyrë të cilën njeriu e fiton si trashëgim;
 - b) Komponenta e shprehive-ajo që ka të bëjë me aspektin e jashtëm të njeriut, e cila s’është dhënë;
 - c) Komponenta e arsyes.
- Fëmijët deri në moshën pesë vjeçare duhet të edukohen vetëm në rrethin familjar;
- Aristoteli thekson veçmas rëndësinë e edukimit fizik për zhvillimin e fëmijës;
- Aristoteli kujdes dhe rëndësi të veçantë I kushtoi lojës;

- Aristoteli flet edhe për përrallat, me anën e të cilave fëmijëve duhet treguar rolin e njerëzve në shoqëri;
- Ai është kundërshtar që I metodave, që fëmijës t'i ndalohej piskatja dhe të qajturit, sepse sipas atij I ndihmojnë dhe kontribuojnë në shëndetin e tij;
- Përgaditjen e fëmijës për shkollë duhet përgaditur prej moshës 5-7 vjeçare;
- Sipas Aristotelit, periudha e dukimit parashkollorë përfundon në moshën shtatë vjeçare të fëmijës.

5. Mark Fobie Kuntiliani (42-118)

- Pedagogu romak, I cili në librin e tij “Mbi edukimin e oratorit” I kushtoi kujdes çështjeve të edukimit parashkollor;
- Sipas tij është me rëndësi të veçant çështja e zgjedhjes së personit, I cili do të merrej me punë edukative dhe arsimor;
- Kuntiliani, përveç lojës, e ka theksuar edhe formën e re, aktivitetin e orientuar, gjatë të cilit fëmijët sistematikisht do të fitojnë dituri mbi botën.

6. Jan Amos Komenski (1592-1670)

- Ishte pedagogu I parë që bëri sistematizimin e diturive dhe të ideve pedagogjike mbi edukatën e fëmijëve të moshës parashkollore;
- Edukimi I fëmijëve parashkollor prej lindjes e deri 6 vjet I takon familjes, të cilën ai e quajti shkolla amnore;
- Sipas Komenskit, përmbajtja e edukatës parashkollore përfshinë:
 - a) Edukatën morale
 - b) Edukatën intelektuale
 - c) Edukatën fizike.

7. Pestaloci (1746-1827)

- Pestaloci është pedagog zviceran, I cili besonte se pozita e jetës së popullit mund të përmirësohet nepërmjet edukatës;
- Edukimi I fëmijës në moshën parashkollore, Pestaloci e shkroi librin “Libri për nëna ose Doracak për nëna”, se si ato mund t’I mësojnë fëmijët për të vërejtur dhe për të folur;
- Edukata fizike, intelektuale, punuese dhe morale ishin përmbajtjet e edukimit parashkollor.

8. Konstantin Ushinski (1824-1870)

- Ushinski ishte pedagog rus. Sipas tij asnjë institucion nuk mund ta zëvendësojë rolin edukativ të familjes;
- Si mjete kryesore educative I konsideronte: krijimtarinë letrare popullore, ljetat, përrallat e përrallëzat.

9. Robert Oveni (1771-1858)

- Sistemi I edukimit dhe arsimimit të Robert Ovenit përfshinë këto forma:
 - a) foshnjoret që I dedikohen edukimit dhe zhvillimit të fëmijës prej lindjes deri në moshën 3 vjeçare;

- b) shkolla për fëmijët e vegjël, e cila I përfshinte fëmijët prej 3 deri në moshën 5 vjeçare;
 - c) shkolla fillore që përfshinte fëmijët prej 5 e deri në moshën 10 vjeçare.
- Puna edukative dhe jeta e fëmijëve të moshës parashkollore zhvilloj në lokale posaçërisht të përgaditura dhe pajisura si dhe në fushat e lojës;
 - Robert Oveni, posaçërisht e potencon nevojën për zgjedhjen e edukatores, e cila duhet të posedonte kryesisht këto komponente: dashuria ndaj fëmijës, të ishte e mirë dhe e ndershme.

10. Fridrih Froebeli (1782-1852)

- Froebeli mendon se familja është hapësira më e rëndësishme ku mund të edukohet fëmija;
- Froebeli zbuloi se dashuria dhe kujdesi janë çelësi I një procesi të edukimit të suksesshëm;
- Froebeli ishte I mendimit se fëmija nëpërmjet vet aktivizimit bëhej I vetëdijshëm për aftësitë e tij dhe arrinte të kuptonte më mirë faktet dhe rrethanat;
- Froebeli ideoi krijimin e një institucioni për fëmijët e vegjël, ku ata mund të përparonin në mënyrë harmonike nëpërmjet vetë aktivizimit në lojëra;
- Ai organizoi kurse për nënat ku ai u mësonte atyre lojëra më këngë si dhe lojëra lëvizëse dhe rrethore;
- Lodrat, Froebeli I quajti dhurata për fëmijë dhe ishin shumë llojesh.

11. Maria Montessori (1870-1952)

- Maria Montessori u lind në Itali;
 - Karrierën e saj e filloi në Fakultetin e Mjekësisë, ku ishte edhe studentja e parë femër në Univerzitetin e Romës;
 - Maria Montessori punën e filloi me edukimin e fëmijëve me të meta mentale;
 - Kur me punën e saj pedagogjike e kuptoi se metoda e saj mund të aplikohet edhe te fëmijët normal, ajo iu përkushtua plotësisht në çdo aspekt dhe krijoi një sistem të edukimit sipas parimeve të saja pedagogjike dhe psikologjike.
 - Qysh në vitet 1900 e hartoi një program vëllimor për fëmijët parashkollor;
 - Maria, e kishte tejet të gjërë konceptsinin mbi edukatën parashkollore;
 - Edukatën e kuptonte si përgatitje për jetë dhe besonte bindshëm se përvoja e hershme fëmijënore ndikon në zhvillimin e më vonshëm të fëmijëve;
 - Në programe e Montessorit, materialet didaktike dhe aktivitetet e fëmijëve kanë të bëjnë më tepër me fëmijët e moshës 2-3-4 vjeç;
 - Montessori insistonte për një motivim të brendshëm të fëmijës;
 - Ajo e hetoi dhe e vërtetoi nevojën e fëmijës për lëvizje, për aktivitet etj;
- Edukimi I lëvizjes në sistemin e Montessorit përfshinë;

- a) manifestimet dhe lëvizjet spontane të fëmijës nga jeta e përditshme;
 - b) mësimin sistematik të lëvizjes;
 - c) ushtrimet gjimnastikore;
 - d) kultivimin e bimëve dhe kafshëve;
 - c) punëdoren
- Parimet e sistemit të Maria Montessorit janë:
 - a) liria e fëmijës për ta zgjedhur ushtrimin, lojën dhe aktivitetin e lirë;
 - b) puna edukativo-arsimore është individuale me fëmijë;
 - c) edukatorja intervenon vetëm në fillim të punës- ushtrimet e fëmijëve janë individuale;
 - d) disiplina mbështetet në lirinë e fëmijëve.

EDUKATA DHE ZHVILLIMI I FËMIJËS PARASHKOLLORE

1.Rritja dhe zhvillimi i fëmijës

- Zhvillimi është karakteristikë e çdo dukurie, posaçërisht e atyre që kanë të bëjnë me njeriun;
- Dukuria e zhvillimit të njeriut është specifike për arsye se ai me vetëdije ndikon në zhvillimin e vet personal dhe njerëzve të tjerë;

- Veprimtaria e tillë quhet edukatë;
- Edukata është veprimtari e vetëdijshme, përmes së cilës zhvillohen funksionet fizike dhe psikike të njeriut;
- Zhvillimi I fëmijës manifestohet në tri lloje kryesore:
 - a) Zhvillimi anatomic
 - b) zhvillimi fiziologjik dhe
 - c) sjellja.
- Zhvillimi si rezultat të vetin e ka paraqitjen e veqorive dhe të aftësive të reja tek individi.
- Zhvillimi I fëmijës përbëhet nga ndryshimet, të cilat klasifikohen në katër klasë kryesore:
 - a) Ndryshimet në madhësi: rritja trupore, rritja e organeve të brendshme, zhvillimi mental, shtimi I fjalorit etj.
 - b) Ndryshimet në proporcion
 - c) Zhdukja e cilësive të vjetra dhe
 - d) Fitimi I cilësive të reja.
- Personaliteti I fëmijës është bazë dhe pikënisje e edukatës.
- Ekzistojnë tri lëminj të zhvillimit të personalitetit siq janë:
 - a) Lëmi konjitiv I zhvillimit: në të bëjnë pjesë: dituritë, botëkuptimet aplikimi, vlerësimi etj.
 - b) Lëmi afektiv: në të bëjnë pjesë pranimi I ndonjë fenomeni, vullneti për të pranuar, reagimi, marrja e qëndrimit, sistematizimi etj.
 - c) Lëmi psikomotorik: në të bëjnë pjesë: imitimi, manipulimi, precizimi etj.
- a) Lëmi konjitiv I zhvillimit: në të bëjnë pjesë: dituritë, botëkuptimet, aplikimi, vlerësimi etj.
- b) Lëmi afektiv: në të bëjnë pjesë: pranimi I ndonjë fenomeni, vullneti për të pranuar, reagimi, marrja e qëndrimit, sistematizimit etj.
- c) Lëmi psikomotorik: në të bëjnë pjesë: imitimi, manipulimi, precizimi etj.
- Zhvillimi fizik I fëmijës është I dukshëm, jo vetëm për mesin por edhe për vetë fëmijën,
- Zhvillimi intelektual I fëmijës edhe pse nuk është aq I dukshëm, sikurse zhvillimi fizik, ai në të gjitha fazat e zhvillimit të fëmijës është present dhe luan rol me rëndësi të madhe për zhvillimin e fëmijës në përgjithësi;
- Fëmija më tepër është në gjendje, që të bëjë diç, se sa edhe që ta kuptojë rëndësinë e aktit të vet;
- Dallimet mes mundësive fizike dhe atyre intelektuale të fëmijës ekzistojnë gati gjatë tërë procesit të zhvillimit të fëmijës.
- Dallime të këtilla paraqiten edhe mes gjinive, ku vajzat gjatë zhvillimit të tyre fizik iu paraprijnë diç djemve.

2. Shkolla c Gjenevës-Zhan Pijazhe

- Mësimet c kësaj shkolle së pari u paraqitën në Zvicër dhe në Francë;
- Sipas kësaj shkolle, zhvillimi intelektual, kalon nëpër katër periudha themelore:
 - a) Periudha senzomotorike (fëmijët 0-2 vjeç)
 - b) Periudha paraoperacionale(fëmijët 2-7vjeçare)
 - c) Periudha e operacioneve konkrete(7-10, 11, vjeçare)
 - d) Periudha e operacioneve formale(11 c më pas).

3. Veçoritë e zhvillimit mendor të fëmijës parashkollorë

- Fëmija në parashkollorë e përjeton një zhvillim mendor tejet të shpejtë;
- Karakteristikat dhe veçoritë kryesore të zhvillimit mendor të fëmijës parashkollorë janë:
 - a) Kërshëria. Ai është motivi më i fortë i tij për të mësuar;
 - b) Të mësuarit. Fëmija parashkollorë mëson më lehtë nëpërmjet fitimit të përvojës, të cilën e fiton gjatë aktivitetit dhe lojës së tij.
 - c) Aftësitë folëse: fëmija aftësitë e veta folëse i përdor si mjet për ta plotësuar kërshërinë, duke shtruar pyetje të ndryshme “Si”, “Ku” etj.
 - d) Interesimi i fëmijës për përralla
 - e) Përceptimi optik: tek fëmijët përceptimi optik i madhësive, formës, ngjyrave dhe i vëllimit të objekteve fillon gradualisht të bëhet përceptim i sakët.
 - f) Kujtesa
 - g) Të menduarit: Te fëmija parashkollor, të menduarit e ka strukturën praktike dhe manifestohet në angazhimin dhe aktivitetin praktik të fëmijës për të zgjidhur problemet e veta konkrete.

4. Edukimi dhe arsimi parashkollor bashkëkohor

- Në moshën parashkollore, ambienti ka rëndësi të theksueshme për zhvillimin e personalitetit;
- Edukimi dhe arsimi parashkollor duhet t’i kontribojë zhdukjes së mos barazisë soci-kulturore dhe për të mundësuar manifestimin e aftësive potenciale të individit;
- Barazimi i kushteve për edukim dhe arsim duhet të fillojë që në moshën parashkollore e jo në nivelin e arsimit fillor e as atë të arsimit të mesëm;
- Pedagogu amerikan Bruneri është marrë me studime për të vërtetuar se si mëson i posalinduri dhe se si ai si foshnje mund të mësojë;
- Bruneri vërtetoi se për fëmijën qysh në moshën 3 mujore ekzistojnë mundësi për një sistem të të mësuarit.

5. Dallimi midis zhvillimit intelektual dhe fizik tek fëmijët

- Zhvillimi intelektual edhe pse nuk është aq i dukshëm sikurse ai fizik e motorik, qysh në moshën më të re parashkollore, jo vetëm që është present, por ai është edhe komponent tejet i rëndësishëm për zhvillimin e fëmijës në përgjithësi;
- Gjatë zhvillimit të fëmijës-zhvillimi intelektual luan rol të rëndësishëm për vetë statusin e përgjithshëm të fëmijës në shoqëri;
- Karakteristikë e përgjithshme e zhvillimit të fëmijës është njëfarë ngecje e tij në aspektin e zhvillimit intelektual.

FAKTORËT E ZHVILLIMIT TË FËMIJËS PARASHKOLLOR

1.Faktorët mbi zhvillimin e fëmijës

- Mospajtimet e shkencëtarve rreth asaj se cili është faktori kryesor
- Shikimet e tilla mund të ndahen në tri grupe:
 - a) Grupi I parë mendojnë se faktor kryesor është faktori I trashigimit dhe se fëmija është produkt I prindërve ose I gjyshit e stërgjyshërve;
 - b) Grupi I dytë I përfaqësuar nga Xhon Loku janë të mendimit se fëmija asgjë nuk sjell me vete dhe se është letër e bardhë. Faktor kryesor për zhvillimin e tij është **edukata**;
 - c) Grupi I tretë mendojnë se për zhvillimin e fëmijës ndikojnë dy faktor: **ai biologjik dhe ai sociologjik.**

- **Faktorët themelorë për zhvillimin e fëmijës janë:**

a) Faktori biologjik

- I posalinduri nga prindërit dhe gjyshërit e tij trashëgon organet anatomike-fiziologjike me sistemin normal nervor;
- Gjendja psikike dhe fizike e nënës ndikojnë në zhvillimin e fëmijës;
- Fëmija saohet nga bashkimi I organizmave të nënës dhe babës;
- Në faktorin biologjik bën pjesë edhe shëndeti I fëmijës

b) Faktori social:

- Zhvillimi I personalitetit ndikohet nga rrethi shoqëror
- Në procesin e zhvillimit psikik të fëmijës, roli kryesor I takon rrethit shoqëror;
 - Është fakt se rrethi natyror ndikon në zhvillimin psikik të fëmijëve, por jo edhe aq ndikueshëm sa faktori biologjik, e as sa ndikimet edukative;
 - Në zhvillimin psikik të fëmijëve ndikon edhe përcjellja e përvojës njerëzore nga ana e të rriturve;
 - Përvetësimi I përvojës me anë të imitimit;
 - Të rriturit udhëheqin me veprimtarinë e fëmijës, e më vonë edhe me prirjet, vlerësimet dhe interesimet e tij;
 - Të rriturit fëmijët e tyre I edukojnë gradualisht dhe qëllimisht.

c) Aktiviteti I fëmijës:

- Faktor tjerë me rëndësi krahas atij biologjik dhe sociologjik është edhe vet aktiviteti I fëmijës;
- Aktiviteti I fëmijës manifestohet dhe shprehet nepërmjet veprimtarisë;
- Tek fëmijët e moshës 2-3 vjeçare, krahas aktivitetit fizik fillon të paraqitet edhe aktiviteti intelektual.

ç) Zhvillimi si rezultat I ndikimeve reciproke të faktorëve biologjik, social dhe aktivitetit të fëmijës:

- Procesi I zhvillimit normal të fëmijës mund të sigurohet vetëm nëpërmjet ndikimit të njëpasnjëshëm të tre faktorëve kryesorë.

2. Edukata si faktor I zhvillimit të personalitetit të fëmijës

- Roli i edukatës si faktor për zhvillimin e personalitetit është jo vetëm tejet I madh, por edhe vendimtar, posaçërisht në moshën parashkollore.
- Edukata si faktor, ka akarakter të thellë social, ngase në kuptim të gjerë ajo supozon edhe huazimin e përvojës nga njerëzit e tjerë.

3. Trashëgimi dhe të fituarit e fëmijës si faktorë te zhvillimit të tij

- Cilësitë trashëguese janë ato të cilat fëmija I trashëgon nga prindërit e vet sipas ligjeve gjenetike.
- Trashëgimia e vetive psikike dhe fizike si p.sh. ngjyra e flokëve, syve, lëkurës, konstrukt I trupit, aftësitë etj.

4. Faktorët e rrethit për zhvillimin e fëmijës

- Faktorët e jashtëm ose të rrethit kanë rol tejet të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës.
- Në faktorët e jashtëm bëjnë pjesë: rrethi shoqëror në të cilin jeton, kultura, mënyrat zotëruese të të menduarit, sistemi I vlerave, mënyrat e edukimit dhe të arsimimit , përkujdesja familjare.
